URDHËR
Nr. 547, datë 30.8.2021

PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË "ALBAUTOR" NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË AUTORIT, PËR VEPRAT MUZIKORE ME APO PA TEKST

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kritereve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, 'Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to'", të ndryshuar, si dhe të legjislacionit në fuqi "Për organizatat jofitimprurëse",

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë "Albautor" si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti